

VENDIM
Nr. 248, datë 21.12.2020

MBI ZGJATJEN E AFATIT TË VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-s, NË LIDHJE ME KËRKESËN E SHOQËRISË “ENERGY SUPPLY - AL” SHPK, PËR RINOVIMIN E LICENCËS NR. 309, SERIA T11/T15, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16, nenit 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 92, pika 1 dhe 2, të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të ndryshuar, të miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 21.12.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 135/14 prot., datë 17.12.2020, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi zgjatjen e afatit të vendimarrjes së Bordit të ERE-s, në lidhje me kërkesën e shoqërisë “Energy Supply – AL” sh.p.k., për rinovimin e licencës nr. 309, seria T11/T15, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Energy Supply - AL” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1185, datë 10.11.2020, ka aplikuar për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, nr. 309, seria T11/T15, miratuar me vendimin e Bordit nr. 6, data 2.2.2011, dhe rinovuar me vendimin nr. 122, datë 14.10.2015.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 195, datë 26.11.2020, ka vendosur të fillojë procedurën për rinovimin e licencës nr. 309, seria T11/T15, të shoqërisë “Energy Supply - AL” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit nr. 6, datë 2.2.2011, dhe rinovuar me vendimin e Bordit nr. 122, datë 14.10.2015, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 4.2.2021.

- Në vijim të kësaj vendimarrjeje u krye njoftimi në median e shkruar me shkresën me nr. 62/41 prot., datë 28.11.2020, për fillimin e procedurës për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Me shkresën nr. 1185/2 prot., datë 2.12.2020, ERE iu drejtua shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe kërkoi plotësimin e dokumentacionit të munguar nga aplikimi i saj, por kjo shkresë është kthyer mbrapsht nga posta dhe është ridërguar sërish në datën 16.12.2020.

- Në nenin 16, pika 6, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, përcaktohet se Bordi do të marrë vendimin për rinovim ose jo të licencës jo më vonë se 20 ditë pune nga fillimi i procedurave për shqyrtimin e një aplikimi, konform kësaj rregulloreje, ndaj për kërkesën e shoqërisë “Energy Supply – AL”, Bordi duhet të marrë vendimin përfundimtar brenda datës 28.12.2020.

- Në nenin 92, pika 1 dhe 2, të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, parashikohet se:

“1. Përveç kur ndalohet shprehimisht nga ligji, në raste të justifikuara, për shkak të kompleksitetit të çështjes, organi publik mund të zgjasë vetëm një herë afatën e përcaktuar, sipas nenit 91 të këtij Kodi.

2. Zgjatja e afatit bëhet për aq sa është e nevojshme për përfundimin e procedurës, në proporcion me vështirësinë e çështjes konkrete, por jo më shumë se kohëzgjatja e afatit fillestar.”.

- Duke qenë se shoqëria nuk është njoftuar ende për vendimarrjen e Bordit, në lidhje me kërkesën e saj dhe për dokumentacionin e konstatuar të munguar, po ashtu duke marrë parasysh

kufizimet e vendosura për shkak të COVID-19, që mund të kenë ndikuar në mosmarrjen e shkresës nga ana e shoqërisë, vlerësohet zgjatja e afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s me 20 ditë pune.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë me 20 ditë punë afatin e vendimmarrjes, në lidhje me kërkesën e shoqërisë “Energy Supply - AL” sh.p.k., për rinovimin e licencës nr. 309, seria T11/T15, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti